



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 5230 Prot.

(Lutemi referojuni në rast përgjigjeje)

Tiranë, më 11 . 11 . 2019

URDHËR

Nr. 58, Datë 11 / 11 / 2019

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR MATURËN SHTETËRORE 2020

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ

1. Miratimin e kalendarit për Maturën Shtetërore 2020, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Arsimore Vendore dhe institucionet arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Rezana VRAPI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Referenca Urdhri nr. 537 datë 08.11.2019 “Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore”	Periudha/Datat
Kreu II Institucionet dhe strukturat përgjegjëse për zhvillimin e provimeve të maturës	
Neni 7, shkronja “o”	Dërgon në QSHA, brenda datës 20 shkurt 2020, listën e qendrave për provimet e Maturës Shtetërore.
Neni 8, shkronja “m”	Plotëson brenda datës 30 prill 2020, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për të gjitha vitet e shkollës së mesme, me përjashtim të vitit të fundit. Secilit maturant/kandidat i jepet një kopje e printuar e rezultateve të hedhura, të firmosura nga maturanti/kandidati, të vulosura dhe të firmosur nga drejtori i shkollës dhe kopja tjetër ruhet në arkivin e shkollës.
Neni 8, shkronja “n”	Plotëson në periudhën 8 – 19 qershor 2020, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për vitin e fundit të shkollës së mesme.
Neni 8, shkronja “p”	Në periudhën 22 – 26 qershor 2020 përfundon procesin e verifikimit dhe konfirmimit të rezultateve në sistem.
Kreu IV Aplikimi për provimet e maturës	
Neni 13, pika 2	Maturanti/kandidati bën aplikimin online, fillimisht në Portalin Qeveritar e-albania në periudhën 15 nëntor – 13 dhjetor 2019, dhe më pas, në portalin “Matura Shtetërore 2020”, në periudhën 18 nëntor – 13 dhjetor 2019. Aplikimi në portalin “Matura Shtetërore 2020”, bëhet edhe sipas afateve të vendosura nga QSHA.
Neni 13, pika 3	KSHMSH-ja, deri më datë 15 dhjetor 2019 afishon në shkollë, një kopje të bazës së të dhënave, të shkarkuar nga portali i Maturës Shtetërore dhe pret vërejtjet e maturantëve/kandidatëve për korrigjime të mundshme në bazën e të dhënave të regjistruara në portalin “Matura Shtetërore”. Brenda datës 10 janar 2020, KSHMSH-ja bën verifikimet dhe korrigjimet përkatëse në sistem.